

# SOPHIA INTERNATIONAL TRADE SH.P.K.

Përfaqësim me ose pa mandat të kompanive të punimit të qelqit/xhamit, dhe kompanive  
Prodhuese të makinerive dhe aksesoreve në lidhje me sektorin e qelqit / xhamit etj

Tiranë (Albania)

Tel/Fax: +355

Cel: +355 68 38 76 308

Mail: [iglassapplications@gmail.com](mailto:iglassapplications@gmail.com)

## STATUTI I SHOQERISË TREGTARE

*"SOPHIA INTERNATIONAL TRADE" SH.P.K*

### KREU I

**Themelimi , Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

#### **Neni 1 :**

**Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1.1.1 Sot më datë **07/01/2024**, unë themeluesi kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **"SOPHIA INTERNATIONAL TRADE" sh.p.k**

1.1.2 Themeluesi i shoqërisë është :

**Piero Saverio GIARDINA**, e datëlindjes 04.06.1975, shtetas italian i identifikuar me numër pashaporte **YB3672278** rezident me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë i pajisur me nr personal **H53604001S**.

#### **Neni 2 :**

**Objekti**

**2.1 Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë**


**"1. Përfaqësim me ose pa mandat të kompanive të punimeve të qelqit/xhamit dhe kompanive prodhuese të makinerive dhe aksesoreve në lidhje me sektorin e qelqit/xhamit të shkrirë dhe qelqit/xhamit të transformuar; - Shit-Blerje të makinerive dhe aksesoreve përkatës për sektorin e qelqit / xhamit të shkrirë dhe xhamit të transformuar; - Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, industriale, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme që konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për vazhdimësinë e objektit të shoqërisë, si dhe të marre pjesë si aksionere në shoqëri ose biznese të tjera; - Konsulencë menaxhimi të logjistikës. Shitje dhe blerje e të gjithë artikujve sportive, çertifikime dhe homologime të ndryshme në fushën e sportit.**

#### **Neni 3 :**

**Kohëzgjatja**

3.1.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë **pa afat**.

#### **Neni 4 :**

**PIERO GIARDINA**  


# SOPHIA INTERNATIONAL TRADE SH.P.K.

Përfaqësim me ose pa mandat të kompanive të punimit të qelqit/xhamit, dhe kompanive Prodhuese të makinerive dhe aksesoreve në lidhje me sektorin e qelqit / xhamit etj

Tiranë (Albania)

Tel/Fax: +355

Cel: +355 68 38 76 308

Mail: [iglassapplications@gmail.com](mailto:iglassapplications@gmail.com)

## Selia

4.1.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:

*Tiranë, Tiranë, Njësia administrative nr.8, Rr e Dibrës, pallati nr.132, ZK 8370, zyra nr.4, kati i I-re*

## KREU II

### KAPITALI

#### Neni 5

##### Kapitali themeltar

- 5.1.1 Kapitali themeltar I krijimit të shoqërisë do të jetë **100.000 leke** . Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë në përputhje me kontributet e tyre do të jetë si më poshtë :
- Ortaku themelues z. **Piero Saverio GIARDINA** : Zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme **100.000 lekë** që përbën **100%** të pjesës së kapitalit
  - Kontributi I ortakut mund të jetë në para ose në natyrë, (perfshihen te drejta, pasuri të luajtshme apo të paluajtshme).

#### Neni 6


##### Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit

- 6.1.1 Kapitali I shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar nëpërmjet kontributeve në para dhe kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto Kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 6.1.2 Në asnje rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur pjesëmarrjen e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.1.3 Zvogëlimi I kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve , e cila merr vendim në të njëjtat kushte në të cilat kërkohet ndryshimi I statutit.
- 6.1.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi I prek ortakët në të njëjtën masë me pjesën e kapitalit që përfaqësojnë.

#### Neni 7

##### Transferimi I kapitalit

- 7.1.1 Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen ose te kalohen nepermjet :
- Kontributit ne kapitalin e shoqerise
  - Shitblerjes se kuotave
  - Trashegimise
  - Dhurimit
  - Cdo menyre tjeter qe parashikon ligji
- 7.1.2 Pjeset e kapitalit jane lehtesisht te transferueshme mes ortakeve, per sa kohe nuk parashikohet ndryshe ne statut.

*Piero Giardina*  


# SOPHIA INTERNATIONAL TRADE SH.P.K.

Përfaqësim me ose pa mandat të kompanive të punimit të qelqit/xhamit, dhe kompanive  
Prodhuese të makinerive dhe aksesoreve në lidhje me sektorin e qelqit / xhamit etj

Tiranë (Albania)

Tel/Fax: +355

Cel: +355 68 38 76 308

Mail: [iglassapplications@gmail.com](mailto:iglassapplications@gmail.com)

7.1.3 Pjeset e kapitalit janë lehtësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

## KREU III

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8


##### Organi Vendimmarres

- 8.1.1 Asambleja e ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.
- 8.1.2 Asambleja e ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.1.3 Asambleja e përgjithshme e ortakeve të shoqërisë është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të mëposhtme :
- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
  - b) Ndryshimet në statutin e shoqërisë.
  - c) Emerimin dhe shkarkimin e administratorëve
  - d) Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabel të autorizuar
  - e) Përcaktimin e përfitimeve për personat e përmenduar në pikën (c) dhe (d)
  - f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare të shoqërisë dhe raporteve të ecurisë tregtare të shoqërisë
  - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë
  - h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
  - i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
  - j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në proceset e tjera ndaj administratorëve
  - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
  - l) Miratimin e rregullave procedurale për mbledhjen e asamblese
  - m) Ceshjete të tjera të parashikuara nga ligji apo në statut
- 8.1.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asambletë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.1.5 Administrator i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asambletë e përgjithshme të shoqërisë
- 8.1.6 Autorizimi është i vlefshëm vetëm për një mbledhje të asamblese së shoqërisë, si për mbledhjet vijuese por që kanë të njëjtin rend dite të punës.

#### Neni 9

##### Menyra e thirrjes së asamblese së përgjithshme

- 9.1.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim, ose nëse parashikohet ndryshe në statut, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkrim apo me postë elektronike duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë nga data e parashikuar e mbledhjes së asamblese së përgjithshme.
- 9.1.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

PIERO GJARDINI  




# SOPHIA INTERNATIONAL TRADE SH.P.K.

Përfaqësim me ose pa mandat të kompanive të punimit të qelqit/xhamit, dhe kompanive Prodhuese të makinerive dhe aksesoreve në lidhje me sektorin e qelqit / xhamit etj

Tiranë (Albania)

Tel/Fax: +355

Cel: +355 68 38 76 308

Mail: [iglassapplications@gmail.com](mailto:iglassapplications@gmail.com)

## Neni 10

### Kuorumi

- 10.1.1 Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.
- 10.1.2 Ne rastet kur asambleja duhet te marre vendime te cilat kerkojne shumice te cilesuar , sipas Nenit .87 te ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese apo me elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te Nenit te ketij ligji.
- 10.1.3 Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungese se kuorunit te permendur me lart, asamblej mblidhet perseri jo me vone se 30 dite , me te njejtin rend dite.

## Neni 11

### Marrja e vendimeve

- 11.1.1 Asambleja e pergjithsme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votive te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit te rregjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.1.2 Asambleja e pergjithshme vendos me shumce te votave te ortakeve pjesemarres per vendime te tjera si :
- Percaktimi I politikave tregtare te shoqërisë.
  - Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
  - Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar.
  - Percaktimin e shperblimeve.
  - Mbikqyrjen e politikave tregtare nga ana e administratoreve, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se se veprimtarise tregtare.
  - Perfaqesimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne procese te tjera ndaj administratoreve
  - Miratimin e rregullave proceduriale ne mbledhjen e asamblese.

Çdo ndryshim ne statut duhet pasqyruar ne QKB per te bere ndryshimet ne skeden tregtare te shoqërisë.

## Neni 12

### Perjashtimi nga e drejta e votes

- 12.1.1 Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim si me poshte :
- Vleresimin e veprimtarise se tij
  - Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
  - Ngritje e nje padie ndaj tij nga shoqeria
  - Dhënien ose jot e perfitimeve te reja
- 12.1.2 Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues I autorizuar, perfaqesuesi vleresohet qe te jete ne te njejtin konflikt interesi ashtu si edhe ortaku qe perfaqeson.

## Neni 13

### Administrimi

Piero Gjerdina  
Trajner

# SOPHIA INTERNATIONAL TRADE SH.P.K.

Përfaqësim me ose pa mandat të kompanive të punimit të qelqit/xhamit, dhe kompanive Prodhuese të makinerive dhe aksesoreve në lidhje me sektorin e qelqit / xhamit etj

Tiranë (Albania)

Tel/Fax: +355

Cel: +355 68 38 76 308

Mail: [iglassapplications@gmail.com](mailto:iglassapplications@gmail.com)

- 13.1.1 Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqërisë. Afati I emrimit eshte 5 (pese ) vjet, me te drejte ripërteritje. Emerimi I administratoreve prodhon efekte pas rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.
- 13.1.2 Administratoret e nje shoqërie tregtare meme, sipas parashikimit Nenit. 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqërie te kontrolluar dhe anasjellas. Cdo emerim qe bie ne kundershtim me dispozitat e mesiperme eshte I pavlefshem.
- 13.1.3 Personat e meposhtem caktohen si administrator te pare te shoqërisë. **Emerimi i administratorit nis nga data e themelimit te shoqërisë 07.01.2024 me nje afat 5-vjecar me date perfundimi 06.01.2029**

Te dhenat e identifikimit  
(Emri, Atesia mbiemri, datelindja)  
**Piero Saverio GIARDINA**  
**04.06.1975**


dhe specimet e nenshkrimit  
(nr. I identifikimit, nenshkrimi)  
**YB3672278**

## Neni 14

### Kompetencat e administratorit

- 14.1.1 Adminstratori ka te drejte e detyrohet te :
- Te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te aktivitetit tregtar te shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme.
  - Perfaqesojne shoqërine tregtare
  - Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqërisë.
  - Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor te kompanise, bilanci e konsoliduar, dhe raportet e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim
  - Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenonje mbarevajtjen dhe ekzistence e shoqërisë.
  - Kryejne rregjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqërisë, sic parashikohet ne ligjin "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit".
  - Raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqërisë tregtare.
  - Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.
- 14.1.2 Adminstratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur :
- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezultone ose ekzistone rreziku qe aktivet e shoqërisë nuk I mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
  - Shoqëria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te madhe sesa 5% e vleres se aktiveve te shoqërisë, qe rezultone ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
  - Shoqëria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak aset, te cilat kane nje vlere me te madhe sesa 5 % e aktiveve te shoqërisë qe rezultone ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 14.1.3 Nese asambleja e pergjithshme emerone me shume sesa nje administrator, ata e administrojne bashkarisht shoqërine.

Piero Giardina





# SOPHIA INTERNATIONAL TRADE SH.P.K.

Përfaqësim me ose pa mandat të kompanive të punimit të qelqit/xhamit, dhe kompanive  
Prodhuese të makinerive dhe aksesorëve në lidhje me sektorin e qelqit / xhamit etj

Tiranë (Albania)

Tel/Fax: +355

Cel: +355 68 38 76 308


Mail: [iglassapplications@gmail.com](mailto:iglassapplications@gmail.com)

- 14.1.4 Asambleja e pergjithsme mund te shkarkoje ne cdo kohe administratorin me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin ndaj administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## Neni 15

### Pergjegjesite e administratorit

- 15.1.1 Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per fje te konsumuara gjate administrimit te shoqërisë.
- 15.1.2 Pasoja e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja e pergjithsme qe I sjellin dem shoqërisë, I ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen , per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit, pasojat perkatese.
- 15.1.3 Përveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15 , 17, 18, te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet :
- Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut, ne mirebesim e ne interes per me te miren e shoqërisë, duke I kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqërisë ne mjedis.
  - Te ushtroje kompetencat qe I njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.
  - Te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim
  - Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezente apo te mundshem, te interesave personale me ato te shoqërisë.
  - Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdes te nevojshem
- 15.1.4 Administratori gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet per cdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqërisë tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
- 15.1.5 Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 3 e 4 te ketij neni, eshte I detyruar te demshperbeje shoqërisë demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ai ose personat e lidhur me te kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administrator ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt, e sipas standartave te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ne menyre solidare.
- 15.1.6 Ne menyre te vacante, por pa u kufizuar ne to, administrator eshte I detyruar ti demshperbleje demet e shkaktuara shoqërisë, nese ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" kryen veprimet e meposhtme :
- U kthen ortakeve kontributet.
  - U paguan ortakeve dividend ose interesa
  - U shperndan aktivet e shoqërisë
  - Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare kur, ne baze te gjendjes financiare , duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese ndaj detyrimeve.
  - Jep kredi
- 15.1.7 Përveç padise per shlyerjen e demit qe I ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale ndaj administratorit.
- 15.1.8 Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe I eshte shkaktuar shoqërisë, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim I asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

PIERO GIARDINA  


# SOPHIA INTERNATIONAL TRADE SH.P.K.

Përfaqësim me ose pa mandat të kompanive të punimit të qelqit/xhamit, dhe kompanive

Prodhuese të makinerive dhe aksesoreve në lidhje me sektorin e qelqit / xhamit etj

Tiranë (Albania)

Tel/Fax: +355

Cel: +355 68 38 76 308

Mail: [iglassapplications@gmail.com](mailto:iglassapplications@gmail.com)

## KREU IV

### Viti Financiar – Ekspertet

#### Neni 16

##### Viti financiar

- 16.1.1 Viti financiar I shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar I shoqërisë fillon ne daten e rregjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Biznesit e mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 17

##### Ekspertet

- 17.1.1 Eksperti ka per detyre te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqërisë , ate vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike, te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 17.1.2 Ne perfundim te kontrollit , eksperti kontabel I autoriuar, pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor, si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, per te cilat eshte I detyruar qe t'ia paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shlytuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.


## KREU V

### Prishja dhe ri-organizimi I shoqërisë.

#### Neni 18

##### Prishja dhe likuidimi

- 18.1.1 Shperndarja ose prishja e shoqërisë ne mund te behet ne cdo kohe :
- Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj.
  - Me vendim te Asamblese se Ortakeve
  - Me hapjen e procedurave te falimentimit.
  - Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te te nenit 4, te ligjit nr.9723 dt.03/05/2007 "Per Qendrn Kombetare te Rregjistrimit".
  - Me vendim te gjykates
- 18.1.2 Ne kete rast ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likuidimit te shoqërisë, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe duke shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne Likuidim e Siper".
- 18.1.3 Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesisë paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte hapur nje procedure falimentimi.
- 18.1.4 Likuidimi kryeht nga likuiduesit e emeruar nga ortaket.

PIERO GIAEDJANA  




# SOPHIA INTERNATIONAL TRADE SH.P.K.

Përfaqësim me ose pa mandat të kompanive të punimit të qelqit/xhamit, dhe kompanive Prodhuese të makinerive dhe aksesorëve në lidhje me sektorin e qelqit / xhamit etj

Tiranë (Albania)

Tel/Fax: +355

Cel: +355 68 38 76 308

Mail: [iglassapplications@gmail.com](mailto:iglassapplications@gmail.com)

18.1.5 Nese ortakët nuk marrin një vendim për caktimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve nga dita e prishjes, çdo pale e interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

## **Neni 19**

### **Riorganizimi I shoqërisë, bashkimi dhe ndarja**

19.1.1 Shoqëria mund të ndahet ose të bashkohet, sipas Vendimit të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të ligjit nr.9901 dt.14/04/2012 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## **Neni 20**

### **Baza Ligjore**

20.1.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plote me këtë statut dhe me legjislacionin shqiptar.

20.1.2 Për sa nuk parashikohen në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodi Civil dhe çfarëdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 21**

### **Mosmarreveshjet**

Për mosmarreveshjet që lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, ssi dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë mes Shoqërisë dhe Të Tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

## **ORTAKU**

### **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

"SOPHIA INTERNATIONAL TRADE" SH.P.K

Piero GIARDINA

PIERO GIARDINA

